



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

nr. 395 , datë 26.01.2016

“Për disa sugjerime në lidhje me projekt-rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SH.A tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Zv/Kryetar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar
- Z. Eduart Ypi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 12.01.2016 dhe 26.01.2016, shqyrtoi projekt rregulloren e ardhur për mendim nga ERE

Objekt: Për procedurën e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SH.A tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike

Baza Ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), neni 69 dhe neni 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të projektvendimit të ERE “Mbi procedurën e blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SH.A tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”.

V Ë R E N S E:

Me anë të shkresës nr. 734 prot, datë 17.12.2015, ERE njofton se me Vendimin nr. 151, date 11.12.2015, filloi procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE SH.A tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”.

Projekt Rregullorja e paraqitur është hartuar në zbatim të nenit 19, germa "1" nenit 62, pika 2, nenit 69, germa "ë", të Ligjit nr. 43/2015, datë 28.05.2015 "Per sektorin e energjise elektrike".

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave për blerjen e energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE SH.A. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike.

Projekt rregullorja e paraqitur ka përmirësime në pjesën e zbatimit që ka përcaktuar OSHEE/Furnizuesin e Shërbimit Universal si blerësin e energjisë elektrike, e cila është në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, date 28.05.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", por në pjesën e procedurës së blerjes së energjisë elektrike i referohet vetëm një operatori si OSHEE.

Por, nga shqyrtimi në tërësi i rregullores, nisur nga shqetësimet e vazhdueshme të tregut dhe procedurave që kryhen gjatë blerjes së energjisë elektrike, konstatohet që kjo draft rregullore nuk i zgjidh të gjitha shqetësimet e tregut në lidhje me trajtimin e barabartë të operatorëve si dhe problematikat e krijuara nga procedura e negocimit etj.

Nisur nga këto shqetësime të vazhdueshme të tregut si edhe bazuar në praktikën më të mira europiane, Komisioni i Konkurrencës është shprehur edhe më parë rreth procedurës së blerjes së energjisë elektrike nga OSHEE me Vendimin nr. 334, datë 31.10.2014 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes", në rekomandimet e dhëna, pika 4 ka rekomanduar: *"Duke marrë në konsideratë faktin që aktualisht në Shqipëri të gjitha procedurat e prokurimit publik janë në formë elektronike dhe realizohen nëpërmjet platformave përkatëse elektronike, kjo procedurë të parashikohet edhe në rregullat e blerjes së energjisë elektrike"*.

Gjithashtu, rregullorja i referohet/apo adreson blerjen e energjisë elektrike kryesisht nga OSHEE, por sipas rekomandimeve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë procedura e blerjes së energjisë elektrike duhet të jetë e njëjtë për gjithë operatorët e tregut të energjisë elektrike (OSHEE, OST, Operatori i Sistemit, Furnizuesin Publik me Shumice dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal), të cilët kryejnë blerje të energjisë elektrike për nevojën e sigurisë dhe mirëfunksionimit të sistemit.

PËR KËTO ARSYE

Në zbatim të nenit 69 dhe nenit 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

V E N D O S I :

I- Ti rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë:

Zbatimin e pikës 4 të Vendimit nr. 334, datë 31.10.2014 të Komisionit të Konkurrencës "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes", dhe më konkretisht:

Projekt rregullorja e blerjes së energjisë elektrike, procedurën e blerjes ta kryejë në bazë të një platforme elektronike, e cila të marrë në konsideratë parimet e transparencës, trajtimit të barabartë të aktorëve të licensuar, për tregtimin e enegjisë elektrike.”

- II- Projekt rregullorja e blerjes së energjisë elektrike të përfshijë gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike të cilët kryejnë blerjen e energjisë elektrike: OSHEE, OST, Operatori i Sistemit, Furnizuesin Publik me Shumice dhe Furnizuesin e Shërbimit Universal.
- III- Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda (_____)	Koço Broka (_____)	Iva Zajmi (_____)	Eduard YPI (_____)
Zv.Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
			Lindita MILO (LATI)

			K R Y E T A R